


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 549 Rep.  
Nr. 96 Kol.



### KONTRATË SHITJE-BLERJE KUOTASH

Sot më datë 07.03.2007, përpara meje Noteres, Znj. Meri Çala, lidhet kjo Kontratë Shitje-Blerje Kuotash (këtëj e tutje referuar "Kontrata"),

*ndërmjet*

- **Nikolle Lesi**, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe, me date 6 gusht 1963, banues ne Rr. Sami Frasheri, pallati Nr.26/1, Tirane, pas. nr. D 0000217 ne cilesine e ortakut te vetem te shoqerise Koha Jone Sh.p.k., me seli ne Rr.Sami Frasheri, Pallatet e aviacionit Nr.4 Tirane;

*dhe*

- **Z. ALEKSANDER FRANGAJ** i biri i Vasilit i Gjystes, qytetar shqiptar, lindur ne Lezhe, me 4.10.1968, banues ne Tirane me adrese ne Rr. Dervish Hima nr. 1, pasaporte nr. S0000672;

Te dy madhore e me zotesi te plote per te vepruar per identitetin e te cileve u sigurova pasi verifikova dokumentat perkates te identifikimit

### KUSHTET PARAPRAKE

- Shitësi zotëron 100% te kuotave te shoqerise Koha Jone Sh.p.k., person juridik shqiptar i regjistruar me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr. 2814, date 11.3.1994, ndryshuar me vendime te mepasshme sipas vendimit te fundit me njembdhjete vendime te mepasshme, kodi fiskal 3706661 dhe Nipt J 71425013C. Akti i themelimit dhe statuti i saj kane pesuar here here ndryshime sic vertetohen nga ekstrakti i regjistrit tregtar prej 33 fletesh bashkengjitur kesaj kontrate si shtojca nr. 1.
- Blerësi ka qene bashkethemelues i shoqerise se bashku me Z. Nikolle Lesi dhe deshiron te bleje 100% te kuotave te shoqerise, mbi bazën e kushteve të mëposhtme.

MEQË EKZISTOJNË KUSHTET PARAPRAKE,  
PALËT BIEN DAKORT PËRSA MË POSHTË:

Neni 1 – Kushtet Paraprake dhe Shtojcat

Kushtet paraprake të mësipërme dhe Shtojcat bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

## Neni 2 – Objekti i Kontratës

Në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, Shitësi i shet Blerësit dhe Bleresi pranon të blejë prej Shitësit 100% të kuotave që Shitësi zoteron tek Shoqëria si edhe çdo të drejtë që lidhet me këto Kuota, të lira nga çdo barrë apo detyrim, për çmimin e parashikuar në Nenin vijues 3, të paguar sipas mënyrës së treguar në atë nen.

## Neni 3 – Çmimi i blerjes

Çmimi i shitblerjes së 100% të kuotave të shoqërisë KOHA JONE shpk. është Euro 100,000 (njëqind mijë) të cilën Bleresi ia paguan Shitësit me nënshkrimin e kësaj kontrate.


## Neni 4 – Transferimi i titullit të Pronesise

Duke qenë se i gjithë çmimi i përcaktuar për pagesën e 100% të kuotave të parashikuar në Nenin e mësipërm 3 është paguar nga Bleresi, e drejta e pronësise së kuotave kalon nga Shitësi tek Bleresi me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe Bleresi do të bëjë regjistrimin e transferimit të Kuotave pranë organeve kompetente.

## Neni 5 – Deklarimet dhe Garancite e Paleve

5.1 Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, palët nëpërmjet këtij akti deklarojnë dhe garantojnë se:

- a) Shitësi është i vetmi pronar i pjesëve të kapitalit të cituara në Kushtet Paraprake;
- b) Pjesët e kapitalit janë emetuar e nënshkruar në mënyrë të rregullt dhe janë shlyer plotësisht;
- c) Pjesët e kapitalit janë të lira nga çdo barrë apo detyrim dhe secili prej Paleve ka të drejtë të plotë për të shitur dhe transferuar Kuotat në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate;
- d) Shoqëria zoteron pasuritë e luajtshme sipas inventarit të bashkëngjitur kësaj kontrate që është pjesë përbërëse e saj
- e) Z. Nikolle Lesi nuk ka regjistruar si markë tregtare emërtimin Koha Jone në favor të ndonjë personi tjetër juridik apo fizik dhe as ka dhënë ndonjë miratim për një gjë të tillë;
- f) Shoqëria nuk ka detyrime ndaj të tjerëve, dhe as ka marrë kredi në ndonjë bankë e nuk ka lënë peng ndonjë prej pasurive të luajtshme të shoqërisë Koha Jone. Çdo detyrim i lindur në lidhje me fakte apo veprime të cilat janë kryer para lidhjes së kësaj kontrate do të jetë në ngarkim të Shitësit dhe çdo e ardhur e siguruar nga shoqëria për efekt të shitjeve të gazetës ose botimit të reklamave apo veprimtari të shoqërisë deri në datën e lidhjes së kësaj kontrate do t'i perkase shitësit.
- g) Shitësi deklaron se ka paguar të gjitha detyrimet për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit sipas ligjit deri në datën e fundit të punës të muajit shkurt 2007;
- h) Bleresi do të levizë redaksinë e gazetës nga selia e saj aktuale brenda një muaji nga lidhja e kësaj kontrate dhe Shitësi e lejon atë të perdore pa shpërblim ambientet aktuale në pronësi të tij ku gjendet redaksia për këtë periudhë një mujore.



Osni



- 5.2 Secili prej Paleve angazhohet, premton dhe garanton tjetrin se me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe ne momentin e transferimit te kuotave ne regjistrin e shoqerive tregtare te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane:
- a) i kalon paleve tjetere respektivisht titull ligjor te plote dhe te parevokueshem mbi Kuotat dhe/ose pjeset e kapitalit; dhe se
  - b) Secila prej paleve qe do te fitoje te drejten e pronesis, do te kete te drejten per te perfituar cdo dividend dhe te gjitha te drejtat qe lidhen me kuotat perkatese. Palet deklarojne se nuk do te kerkojne asnje dividend te prapambetur te pashperndare apo te pa marre ne lidhje me kuotat dhe se te vetmet shuma per te mbledhur jano ato nga reklammat e bera para kesaj date dhe gazetat e shitura sipas percaktimeve te bera ne nenin 5.2. e me siper .
- 5.3. Me nenshkrimin e kesaj kontrate Shitesi garanton se Z. Bardhyl Ucaj do te jape doreheqjen nga administrimi i shoqerise dhe se cdo marredhenie me te do te jete ne ngarkim te Shitesit.


## 6. Detyrimet te tjera te Bleresit

6.1. Per nje periudhe nje vjecare duke nisur nga data e neshkrimit te kesaj kontrate Shitesi do te kete te drejte te botoje reklame komerciale ne nje faqe te brendshme te gazetes. Te ardhurat e perfituara nga botimi i kesaj reklame komerciale do t'i takojne Shitesit. Shitesi do te jete vete pergjegjes per gjetjen e reklamave dhe Bleresi nuk ka asnje lloj pergjegjesie monetare ne lidhje me faktin nese Shitesi nuk arrin te gjeje reklame e nuk realizon te ardhura te tjera nga kjo e drejte per botim reklame e perfituar mbi bazen e kesaj kontrate. Per te evituar cdo dyshim, ne rast se Shitesi nuk do te arrije te gjeje e vendose reklame ne gazete ne te gjitha faqen ose nje pjese te saj, Bleresi do te kete te drejte te perdore lirisht per qellimet e tij te gjithen ose ate pjese te faqes se gazetes te mbetur bosh.

6.2. Bleresi deklaron shprehimisht dhe angazhohet se Redaksia e gazetes Koha Jone nuk do te sulmoje apo fyeje themeluesin e saj zotin Nikolle Lesi dhe as familjen e tij ne faqet e kesaj gazete. Nese nga pakujdesia dhe moskontrolli i kryeredaktorit ndodh qe zoti Lesi te ndjehet i demtuar, Bleresi merr persiper ti kerkoje ndjese publike ne gazete dhe ti jape zotit Lesi hapësiren e nevojshme per te rikuperuar ate gabim te mundshem.

## Neni 7- Trashegimtaret apo perfituesit nga ndonje kalim apo cedim

Kjo Kontrate do te jete detyruese apo ne perfitim te Paleve dhe trashegimtareve apo perfituesve te tyre per shkak te ndonje kalimi apo cedimi. Ne menyre te vecante, duke qene thelbersor per shitesin detyrimi i parashikuar ne nenin 6 me siper, cdo transferim eventual i mespashem i kuotave te shoqerise nga Bleresi tek te tretet duhet te permbaje shprehimisht detyrimin e e parashikuar ne nenin 6, ne te kundert kontrata e transferimi te kuotave tek te tretet do te jete e pavlefshme.



### **Neni 8 – Shpenzimet dhe Taksat**

Te gjitha shpenzimet ligjore te noterise lidhur me kete Kontrate do te perballohen ne menyre te barabarte nga Palet e kesaj Kontrate ndersa taksat sipas parashikimeve ligjore.

### **Neni 9 - Njoftimet**

Te gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera te kerkuara ose qe duhet te jipen sipas kesaj Kontrate do te behen me shkrim dhe do te konsiderohen se jane dhene nese i dorezohen Paleve personalisht apo dergohen me faks (me konfirmim), postohen me poste rekomande (me kthim pergjigje) ne adresat e meposhtme apo ne ato adresa qe mund te ndryshohen dhe njoftohen me shkrim:

per Z. Nikolle Lesi : Rr. Sami Frasherri Pallati Nr. 26/1 Tirane.

per Z. Aleksander Frangaj: Rr. Dervish Hima nr. 1, kati 9, Tirane.

### **Neni 10 – Legjislacioni i zbatueshem**

Kjo Kontrate dhe te drejtat e detyrimet e Paleve do te rregullohen dhe nga legjislacioni shqiptar.

### **Neni 11 – Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Ne rast mosmarreveshje midis Paleve lidhur me interpretimin, ekzekutimin, shkeljen, perfundimin apo zbatueshmerine e kesaj Kontrate dhe Shtojcave perkatese, Palet do te takohen dhe perpiqen ne mirebesim te zgjidhin sa me shpejt qe te jete e mundur mosmarreveshjen ne fjale. Nese kjo mosmarreveshje nuk mund te zgjidhet me mirekuptim, gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimet e se ciles jane te ankimueshme sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.

### **Neni 12– Te ndryshme**

- 12.1 Kjo Kontrate e shkruar perben te gjithe marreveshjen ndermjet Paleve dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme verbale apo me shkrim dhe çdo komunikim tjetër te meparshem ndermjet Paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.
- 12.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, çdo ndryshim i kesaj Kontrate mund te behet vetem me marreveshje me shkrim, nenshkruar nga te dyja Palet.
- 12.3 Palet pranojne se kushtet dhe afatet e kesaj Kontrate jane konfidenciale dhe nuk mund t'i behen te ditura paleve te treta, perveç rasteve kur kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.
- 12.4 Kjo Kontrate nenshkruhet ne 4 (kater) kopje origjinale ne shqip.